



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia
Bashkiake Nr. 5
TEL: 698227426

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 4099

Nr. koleksioni: 2407

Tirane më 21/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020053150209969132



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia
Bashkiake Nr. 5
TEL: 698227426

VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

Nr. repertori: 4100

Tirane më 21/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020053150147998856

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ERMAL XH. HAMZAJ

DATE 21/10/2020
NR REP 4100



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 21.10.2020, para meje Noter ERMAL XH. HAMZAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga: "Pashko Vasa", Pallati Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia Bashkiake Nr. 5, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Ermal Yzeiraj, atësia Barjam, amësia Luljeta, shtetas Shqiptar, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Visha; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 21/10/1980, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032988570 dhe nr. personal I01021122W, .

NËNSHKRUES/IT:

Emiliano Doko, atësia Halit, amësia Fize, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë dhe banues në Tiranë, me adresë Petro Nini Luarasi 'daniela'; Nd. 2; H. 12; Ap. 45; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 07/06/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034332016 dhe nr. personal H90607063U, .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noter, Statut te Shoqerise "LAWYERS & MORE" Shpk, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "e", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
ERMAL XH. HAMZAJ



Nr. 4077 Rep
Nr. 2407 Kol

TAKSA E PULLES
U PAGUA
ERMAI HAMZAJ

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË “LAWYERS & MORE” SHPK

Sot në Tiranë, më datë 21.10.2020, ne hartuesit dhe nënshkruesit e këtij Akt Themelimi dhe Statuti; të bindur në vlerat dhe cilësitë njerëzore dhe profesionale të gjithsecilit prej nesh; me qëllimin për të krijuar, zhvilluar dhe ofruar në treg një paketë shërbimesh cilësore, inovative dhe multidimensionale në fushën juridike, financiare dhe atë të auditimit; në zbatim të përcaktimeve ligjore të bëra në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; me vullnetin tonë të lirë dhe në zotësi të plotë juridike për të vepruar; biem dakord në krijimin e kësaj shoqërie tregtare, si më poshtë:

KAPITULLI – I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Emri i plotë i shoqërisë tregtare është: “LAWYERS & MORE” SHPK, referuar në vijim si “Shoqëria”.
- 1.2 Logo, vula dhe çdo element tjetër dallues që lidhet me imazhin, vërtetësinë dhe sigurinë e dokumentacionit të Shoqërisë, miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 2 Baza dhe forma ligjore

- 2.1 Shoqëria është themeluar, organizuar dhe ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të përcaktimeve të bëra në këtë Statut, në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe në kuadrin përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria është person juridik, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), ku përgjegjësia e çdo ortaku të kësaj shoqërie kufizohet në shumën përkatëse të kontributeve të tyre në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- 2.3 Shoqëria mund të shndërrohet në të ardhmen në një formë tjetër ligjore, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Statut si dhe në kuadrin përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



Neni 3 Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: “Rr. “Donika Kastrioti”, Godina Nr. 3 “Kotoni Business Center”, përballë Gjykatës Kushtetuese, Kati 2, Tiranë, Shqipëri”.
- 3.2 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, Shoqëria mund të ndryshojë adresën e selisë së saj, si dhe mund të krijojë, të vendosë në operim funksional, të pezullojë apo të mbyllë edhe degë, filiale, pika pune, agjenci, zyra përfaqësimi dhe lloje të tjera zyrash sekondare, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4 Ortakët

- 4.1 Ortakët themelues të Shoqërisë janë:
- (1) z. Ermal YZEIRAJ, shtetas Shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i lindur më datë 21.10.1980 në Kukës, Shqipëri; banues në adresën: “Rr. Pjetër Budi”, Kompleksi “Ana”, Tiranë, Shqipëri”; mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. 032988570;
 - (2) z. Emiliano DOKO, shtetas Shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i lindur më datë 07.06.1979 në Kuçovë, Shqipëri; banues në adresën: “Rr. Petro Nini Luarasi”, Pallati “Daniela”, Tiranë, Shqipëri”; mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. 034332016.

Neni 5 Objekti i veprimtarisë

- 5.1 Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë është dhënia ndaj palëve të treta e shërbimeve të konsulencës, asistencës, studimit, ekspertizës, përfaqësimit, ndërmjetësimit, trajnimit, lobimit/advokimit dhe mbrojtjes ligjore, në çdo fushë të së drejtës, atë ekonomiko - financiare, si dhe atë të auditimit, përpara çdo entiteti dhe çdo shkalle të proceseve civile, administrative, gjyqësore dhe ligjbërëse në Republikën e Shqipërisë.
- 5.2 Përveç objektit kryesor të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë edhe çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga legjislacioni i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.
- 5.3 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Statut si dhe në kuadrin përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6
Kohëzgjatja

- 6.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar dhe fillon që nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), moment në të cilin Shoqëria fiton dhe personalitetin e saj juridik.

KAPITULLI - II
KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

Neni 7

Vlera e regjistruar e kapitalit themeltar dhe vlera nominale e kuotave

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është: 100 (njëqind) LEK (ALL).
- 7.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të paguara nga dhe në pronësi të Ortakëve të Shoqërisë, si më poshtë:
- (1) z. Ermal YZEIRAJ, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 50 (pesëdhjetë) LEK (ALL), e cila përfaqëson 50 (pesëdhjetë) përqind të kapitalit të Shoqërisë;
 - (2) z. Emiliano DOKO, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 50 (pesëdhjetë) LEK (ALL), e cila përfaqëson 50 (pesëdhjetë) përqind të kapitalit të Shoqërisë.
- 7.3 Secila kuotë është e pandashme në raport me Shoqërinë e cila njih vetëm një zotërues për secilën kuotë.
- 7.4 Çdo kuotë përfaqëson një votë në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve.
- 7.5 Për çdo kuotë Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë kuote.
- 7.6 Shoqëria mban në selinë e Shoqërisë, një regjistër të veçantë, të krijuar dhe rifreskuar vazhdimisht nga njëri prej Administratorëve të Shoqërisë, në të cilin evidentohen certifikatat e lëshuara në lidhje me kuotat dhe transferimet që mund ti kenë ndodhur atyre.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet që lidhen me pronësinë mbi kuotat

- 8.1 Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve, të cilat rrjedhin nga zotërimi i kuotës/kuotave të shoqërisë, fillojnë që nga momenti i zotërimit të kuotës/kuotave dhe shuhet që në momentin e humbjes së zotërimit të kuotës/kuotave, për aq sa nuk është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë.



Të drejtat

- 8.2 Ortakët e Shoqërisë, gëzojnë dhe mund të ushtrojnë në mënyrë të pakufizuar këto të drejta:
- (1) të drejtën për tu informuar/njoftuar në lidhje me aktivitetin/axhendën e mbledhjeve/vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
 - (2) të drejtën për të marrë pjesë dhe votuar në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
 - (3) të drejtën për të inspektuar librat e llogarive të Shoqërisë dhe çdo dokument tjetër shkresor apo elektronik, të prodhuara nga Shoqëria apo administruar prej saj;
 - (4) të drejtën për të kërkuar dhe marrë informacion, nga Administratorët apo çdo punonjës tjetër i Shoqërisë, në lidhje me menaxhimin e Shoqërisë dhe aktivitetin e tyre;
 - (5) të drejtën për të kandiduar dhe zgjedhur në pozicione menaxheriale në Shoqëri;
 - (6) të drejtën për të marrë pjesë në ndarjen e fitimeve të Shoqërisë; si dhe
 - (7) çdo të drejtë tjetër të përcaktuar për ta në: (i) Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, apo në (ii) kuadrin përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Detyrimet

- 8.3 Ortakët janë të detyruar që të ruajnë sekretin dhe konfidencialitetin e fakteve, informacioneve dhe dokumenteve shkresore apo elektronike, që lidhen me Shoqërinë dhe veprimtarinë e saj, të cilat në rast se përhapen dhe i bëhen me dije në çfarëdolloj forme palëve të treta, mund të dëmtojnë interesat e shoqërisë. Mosrespektimi i këtij detyrimi i ngarkon ata me përgjegjësinë dhe detyrimin e kompensimit të Shoqërisë për dëmet e shkaktuara asaj si pasojë e përhapjes së këtyre fakteve, informacioneve dhe dokumentacioneve.
- 8.4 Detyrimet që mund të lindin nga zotërimi i kuotave sigurohen vetëm nga vlera e kapitalit themeltar të Shoqërisë dhe Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e kuotës që ata zotërojnë.
- 8.5 Të ardhurat, llogaritë financiare dhe asetet e Shoqërisë, nuk mund të ngarkohen me detyrime që rrjedhin nga detyrimet apo përgjegjësitë e tjera personale të Ortakëve dhe as të përdoren për shlyerjen e tyre.

Neni 9 Transferimi i kuotave

- 9.1 Në rastin kur çdonjëri prej Ortakëve të Shoqërisë, dëshiron të shesë apo transferojë në çfarëdolloj mënyrë tjetër të ligjshme pronësinë mbi kuotën/kuotat, totalisht apo pjesërisht, apo të tërhiqet nga Shoqëria, Ortaku ka detyrimin që kuotën/kuotat t'ia ofrojë fillimisht për shitje Ortakëve të tjerë të Shoqërisë, në një vlerë të barabartë me vlerën e tyre nominale, duke qenë i lirë në përzgjedhjen e



radhës së tyre. Vetëm në rast të refuzimit të blerjes së kuotës/kuotave nga ana e secilit prej Ortakëve, atëherë kuota/kuotat mund ti ofrohen për shitje apo transferohen në çfarëdolloj mënyre tjetër të ligjshme, palëve të treta (persona fizik apo juridik), të cilët gjithsesi e fitojnë pronësinë mbi kuotën/kuotat vetëm pasi të jetë dhënë me vendim edhe miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

- 9.2 Në rastin fatkeq të vdekjes së ndonjërit prej Ortakëve, të drejtat, detyrimet, përfitimet dhe çfarëdolloj benefiti tjetër dhënë apo premtuar atij zyrtarisht nga Shoqëria, duke përfshirë këtu edhe pronësinë mbi kuotën/kuotat, i kalojnë trashëgimtarëve të tij të ligjshëm, të cilët në rast se dëshirojnë që të shesin kuotën/kuotat e përfituara përmes trashëgimisë apo transferojnë ato në çfarëdolloj mënyre tjetër të ligjshme, duhet të respektojnë dhe zbatojnë përcaktimet e mësipërme të bëra në pikën 9.1, të nenit 9, të këtij Statuti.
- 9.3 Çdo shitje apo transferim i çfarëdolloj mënyre tjetër i kuotës/kuotave që nuk respekton dhe/apo bie ndesh me përcaktimet e mësipërme, të bëra në pikën 9.1 dhe 9.2, të nenit 9, të këtij Statuti, do të konsiderohet si e pavlefshme, dhe Shoqëria si dhe Ortakët e tjerë të saj nuk do të ngarkohen me asnjë përgjegjësi dhe detyrim që do të lind në këtë rast nga procesi i paligjshëm i shitjes/transferimit.

Neni 10

Shtimi dhe pakësimi i kapitalit themeltar

- 10.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë mund të shtohet përmes vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me:
- (1) shtimin e një kuote tjetër të re, me të njëjtën vlerë apo vlerë të ndryshme nominale nga kuotat e tjera ekzistuese, e cila duhet patjetër që të blihet më pas ose nga njëri prej Ortakëve ekzistues në respektim të të drejtës së tyre të parablerjes, ose nga një Ortak i ri i cili mund ta blejë këtë kuotë pas refuzimit të së drejtës së parablerjes së të gjithë Ortakëve ekzistues dhe i cili i fiton të drejtat e tij si Ortak dhe si pronar i kuotës vetëm pas miratimit paraprak me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
 - (2) shtimin e vlerës nominale së kuotave ekzistuese;
 - (3) shtimin e kontributeve në natyrë, të cilat në çdo rast duhet të shoqërohen me një raport vlerësimi të kryer nga një ekspert i kontraktuar nga Shoqëria;
 - (4) zbatimin e çdo mënyre tjetër të lejuar nga kuadri përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 10.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë mund të pakësohet përmes vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me:
- (1) pakësimin e numrit të kuotave;
 - (2) pakësimin e vlerës nominale të kuotës
 - (3) zbatimin e çdo mënyre tjetër të lejuar nga ligji.



KAPITULLI – III ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 11 Organet drejtuese të Shoqërisë

- 11.1 Organet drejtuese të Shoqërisë janë:
- (1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
 - (2) Administratori/Administratorët.

Neni 12 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve përbëhet nga të gjithë Ortakët e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi dhe autoriteti më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve drejtohet nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve i cili duhet të jetë patjetër njëri prej Ortakëve të Shoqërisë. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve zgjidhet me unanimitet votash të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, për një mandat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë të pakufizuar rizgjedhjeje. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve mund të shkarkohet në çdo kohë, me apo pa arsye, me shumicë të zakonshme të votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe në rastin kur Shoqëria ka vetëm dy Ortakë me votën e njërit prej tyre.
- 12.2 Si rregull i përgjithshëm, çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve merret në prezencë të të gjithë anëtarëve të Asamblesë dhe vetëm nëse ata shprehin unanimisht, përmes votës së tyre, të njëjtin qëndrim. Përjashtim nga ky rregull përbëjnë rastet e parashikuara ndryshe në këtë Statut apo dhe në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të cilat specifikojnë limite të tjera të kuorumit të pjesëmarrjes dhe votimit në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve.
- 12.3 Në rastet e ekzistencës së më shumë se dy Ortakëve në Shoqëri, me kërkesë të çdonjërit prej tyre, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve kalon automatikisht në procedura të votimit të fshehtë për marrjen e vendimeve të caktuara.
- 12.4 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, krijon, mban dhe azhuron Regjistrin e Vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, përmbajtja e të cilit nuk mund të fshihet ose ndryshohet dhe në të cilin regjistrohen çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe në veçanti:
- (1) vendimet mbi pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
 - (2) vendimet mbi shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve të Shoqërisë;
 - (3) vendimet për rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
 - (4) vendimet në lidhje me investimet e Shoqërisë;
 - (5) vendimet në lidhje me riorganizimin/prishjen e Shoqërisë.



- 12.5 Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve i cili nuk është regjistruar në Regjistrin e Vendimeve është dhe do të konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm.



Neni 13

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ka për kompetencë dhe përgjegjësi:

Kompetenca dhe përgjegjësi që lidhen me organizimin

- (1) të miratojë/ndryshojë/amendojë Statutin e Shoqërisë;
- (2) të miratojë/ndryshojë/amendojë rregullore specifike të Shoqërisë;
- (3) të marrë vendime në lidhje me ndryshimin e adresës së selisë së Shoqërisë apo ngritjen, vënien në operim funksional, pezullimin apo mbylljen e degëve, filialeve, pikave të punës, agjencive, zyrave të përfaqësimit dhe llojeve të tjera të zyrave sekondare të Shoqërisë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- (4) të emërojë, pezullojë, shkarkojë, dhe shpërblejë Kryetarin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve e Shoqërisë;
- (5) të emërojë, pezullojë, shkarkojë, dhe shpërblejë Administratorët e Shoqërisë;
- (6) të marrë vendime në lidhje me shtimin/pranimin e Ortakëve të tjerë në Shoqëri dhe kuotat e tyre përkatëse;
- (7) të caktojë/emërojë, pezullojë, shkarkojë/tërheqë, dhe shpërblejë (nëse ka dhe nëse do të duhet të ketë) audituesit, likuiduesit, dhe/apo ekspertët kontabël të Shoqërisë;
- (8) të marrë vendime në lidhje me shkrirjen, bashkimin, riorganizimin, ndarjen, shpërbërjen, prishjen, transformimin ose shndërrimin e formës së saj ligjore, apo likuidimin e Shoqërisë;
- (9) të marrë vendime në lidhje me përmbajtjen, lidhjen, pezullimin apo ndërprerjen e kontratave që Shoqëria lidh me Partnerët e saj dhe/apo palët e treta;
- (10) të shqyrtojë dhe vendosë për të marrë masa konkrete përpara i përket kryerjes së hetimeve të posaçme, rishikimit dhe mbikëqyrjes së punës/shërbimit të kryer nga punonjësit, Administratorët, dhe/apo Partnerët e Shoqërisë, dhe palët e treta në marrëdhënie kontraktore me Shoqërinë;
- (11) të caktojë me prokurë përfaqësues të Shoqërisë për çështje/aktivitete të ndryshme;
- (12) të marrë vendime në lidhje me përfaqësimin e Shoqërisë në procedurat gjyqësore ku Shoqëria është palë;
- (13) të përfaqësojë Shoqërinë në procedurat ligjore, administrative apo gjyqësore, kundër Administratorëve të Shoqërisë;
- (14) të marrë/ushtrojë/delegojë çdo kompetencë e cila nuk i është dhënë, nuk i është deleguar apo nuk mund të ushtrohet përkohësisht prej një organi/punonjësi tjetër të Shoqërisë;
- (15) të marrë vendime në lidhje me dhe të ushtrojë çdo kompetencë/përgjegjësi tjetër që i njihet nga kuadri përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe/ose ky Statut;

Kompetenca dhe përgjegjësi që lidhen me financat dhe asetet

- (16) të marrë vendime në lidhje me përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe të mbikëqyrë zbatimin e tyre nga ana e Administratorëve dhe/apo punonjësve të tjerë të Shoqërisë;
- (17) të shqyrtojë/miratojë (i) pasqyrat vjetore financiare dhe (ii) përfitimet/humbjet vjetore të Shoqërisë, të paraqitura nga Administratorët e Shoqërisë;
- (18) të shqyrtojë/miratojë raportet e ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë, të paraqitura nga Administratorët e Shoqërisë;
- (19) të shqyrtojë/miratojë buxhetin e vitit pasardhës të Shoqërisë;
- (20) të shqyrtojë/miratojë draft vendimet e përgatitura nga Administratorët e Shoqërisë në lidhje me shpërndarjen/alokimin e fitimeve;
- (21) të shqyrtojë/miratojë draft vendimet e përgatitura nga Administratorët e Shoqërisë në lidhje me mekanizmat që do të ndiqen për rikuperimin e humbjeve të Shoqërisë;
- (22) të vendosë në lidhje me zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- (23) të vendosë në lidhje me shtimin apo pakësimin e numrit të kuotave ekzistuese dhe vlerës së tyre nominale;
- (24) të vendosë në lidhje me lirimimin e kapitaleve rezervë;
- (25) të marrë vendime në lidhje me dhënien me qira të aktivitetit/aktiviteteve të Shoqërisë apo aseteve të saj, si dhe të vendosë kufizime në lidhje me të drejtat e përdorimit të tyre nga qiramarrësit;
- (26) të shqyrtojë pretendimet e ndryshme që mund të bëhen kundër Administratorëve, Partnerëve apo punonjësve të Shoqërisë, në lidhje me rimbursimin që duhet të bëhet nga ana e tyre për dëmet që ata i kanë shkaktuar Shoqërisë.

13.2 Për çështjet që kanë të bëjnë me:

- (i) shkarkimin/pezullimin e Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, sipas përcaktimeve të bëra në pikën (4), të pikës 13.1, të nenit 13, të këtij Statuti;
- (ii) shkarkimin/pezullimin e Administratorëve të Shoqërisë, sipas përcaktimeve të bëra në pikën (5), të pikës 13.1, të nenit 13, të këtij Statuti;
- (iii) caktimin/emërimin (nëse ka dhe nëse do të duhet të ketë) të audituesve, likuiduesve, dhe/apo ekspertëve kontabël të Shoqërisë, sipas përcaktimeve të bëra në pikën (7), të pikës 13.1, të nenit 13, të këtij Statuti; si dhe
- (iv) shqyrtimin dhe marrjen e masave konkrete përsa i përket kryerjes së hetimeve të posaçme, rishikimit dhe mbikëqyrjes së punës/shërbimit të kryer nga punonjësit, Administratorët, dhe/apo Partnerët e Shoqërisë, dhe palët e treta në marrëdhënie kontraktore me Shoqërinë, sipas përcaktimeve të bëra në pikën (10), të pikës 13.1, të nenit 13, të këtij Statuti;

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, në rastin e mosarritjes së një unanimiteti, mund të marrë vendim edhe me shumicë të zakonshme të votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, ndërsa në rastin kur Shoqëria ka vetëm dy Ortakë me votën e njërit prej tyre.

Neni 14
Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

Mbledhjet e zakonshme

- 14.1 Administratorët, Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe/apo Ortakët e Shoqërisë, thërrret/thërrasin në mbledhje të zakonshme Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në rastet kur:
- (1) Ortakët duhet të vendosin në lidhje me një apo disa nga çështjet që janë në kompetencë dhe përgjegjësi të saj, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 12.1, të nenit 12, të këtij Statuti;
 - (2) zhvillimi i mbledhjes dhe/apo marrja e një vendimi është e domosdoshme për interesin e Shoqërisë;
 - (3) në pasqyrat vjetore financiare ose dhe në pasqyra të tjera të përkohshme financiare të Shoqërisë, rezulton ose ekziston rreziku që Shoqëria ka humbur gjysmën e stokut të kapitalit;
 - (4) në pasqyrat vjetore financiare ose dhe në pasqyra të tjera të përkohshme financiare të Shoqërisë, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim;
 - (5) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në ndonjë mënyrë tjetër, aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 (pesë) përqind të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
 - (6) një gjë e tillë është përcaktuar nga kuadri përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë apo ky Statut.
- 14.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, zhvillon të paktën një herë në vit, mbledhje të zakonshme me qëllimin e shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve në lidhje me:
- (1) pasqyrat vjetore financiare dhe përfitimet/humbjet e Shoqërisë përgjatë vitit të mëparshëm financiar; si dhe
 - (2) buxhetin e vitit pasardhës.
- 14.3 Mbledhjet e zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, zhvillohen duke i njoftuar paraprakisht të gjithë anëtarët e Asamblesë në lidhje me datën, vendin, orën dhe axhendën e mbledhjes ku sqarohen çështjet që do të shqyrtohen dhe/apo votohen. Njoftimi duhet të dërgohet të pakët 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes së zakonshme, afat i cili mund të jetë i ndryshueshëm në varësi të dakordësisë ndërmjet Administratorit/Administratorëve dhe anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 14.4 Për nevoja të vërtetimit të autencitetit të dokumenteve të Shoqërisë si dhe për nevoja të zhvillimit të komunikimeve shkresore apo elektronike, Shoqëria administron në një regjistër të veçantë nënshkrimin zyrtar (firmën), shkrimin e emrit dhe mbiemrit, adresën zyrtare postare, adresën zyrtare të e-mail(it), numrin zyrtar të telefonit mobile, dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të:
- (1) anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre me prokurë;
 - (2) Administratorëve të Shoqërisë;
 - (3) çdo punonjësi tjetër të Shoqërisë me detyra të rëndësishme ekzekutive dhe/apo menaxheriale.



- 14.5 Normalisht, mbledhjet e zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve do të zhvillohen në ambientet e selisë së Shoqërisë, përveç rasteve kur anëtarët e Asamblesë bien dakord paraprakisht për zhvillimin e mbledhjeve në një ambient tjetër.

Mbledhjet e jashtëzakonshme

- 14.6 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe secili prej Ortakëve apo Administratorëve, mund të kërkojnë në çdo kohë zhvillimin e një mbledhje të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në një rast të tillë, Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, Ortaku, apo Administratori që ka kërkuar zhvillimin e mbledhjes së jashtëzakonshme, duhet të njoftojë paraprakisht anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me:
- (1) arsyet e bërjes së një kërkesë të tillë për zhvillimin e një mbledhje të jashtëzakonshme, si dhe
 - (2) datën, vendin, orën dhe axhendën e mbledhjes së jashtëzakonshme ku sqarohen çështjet që do të shqyrtohen dhe/apo votohen.

Mbledhjet e zhvilluara përmes komunikimit elektronik

- 14.7 Në raste të veçanta dhe për arsye objektive, prezenca/vota e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në mbledhjet e zakonshme apo të jashtëzakonshme, mund të sigurohet/jepet edhe në mënyrë elektronike, fakt ky i cili duhet të evidentohet në shkresën e vendimit.

Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në rastet kur njëri apo disa prej anëtarëve të saj kanë marrë pjesë dhe kanë shprehur votën e tyre përmes komunikimit elektronik, hyjnë në fuqi vetëm pas konfirmimit me e-mail të votës së tyre në lidhje me draft-vendimin e diskutuar dhe propozuar për votim dhe të dërguar atyre më parë po me e-mail.

Shkresa e vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në rastet kur njëri apo disa prej anëtarëve të saj kanë marrë pjesë dhe kanë shprehur votën e tyre përmes komunikimit elektronik, duhet të nënshkruhet nga ana e anëtarëve jo prezent fizikisht, në momentin më të parë të mundshëm.

Përfaqësimi me prokurë

- 14.8 Në raste të veçanta dhe për arsye objektive, prezenca dhe vota e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në mbledhjet e zakonshme apo të jashtëzakonshme, mund të sigurohet/jepet edhe përmes përfaqësuesve të tyre me prokurë, e cila duhet tu bëhet me dije të gjithë anëtarëve të tjerë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve përpara ose që në fillim të zhvillimit të mbledhjes së zakonshme apo të jashtëzakonshme.
- 14.9 Përfaqësimi me prokurë mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite



Procesverbali i mbledhjeve

- 14.10 Pas përfundimit të çdo mbledhje të zakonshme apo të jashtëzakonshme, të gjithë anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, duhet të nënshkruajnë procesverbalin e mbledhjes, ku evidentohen në mënyrë të detajuar:
- (1) data, vendi dhe ora e mbledhjes;
 - (2) fakti nëse mbledhja është e zakonshme apo e jashtëzakonshme;
 - (3) personin që ka bërë thirrjen për mbledhje;
 - (4) pjesëmarrësit fizik dhe/apo pjesëmarrësit përmes komunikimit elektronik në mbledhje;
 - (5) axhenda e mbledhjes, ku specifikohen çështjet e shtruarra për diskutim/votim;
 - (6) dokumentet shkresorë apo elektronikë të marra në shqyrtim para apo gjatë zhvillimit të mbledhjes;
 - (7) fjala e thënë nga çdo pjesëmarrës në mbledhje;
 - (8) vendimet dhe votat e marra/dhëna në mbledhje nga secili prej anëtarëve të Asamblesë apo përfaqësuesi i tyre me prokurë;
 - (9) emrin, mbiemrin, funksionin dhe nënshkrimin e personit që ka mbajtur dhe ka hartuar procesverbalin e mbledhjes;
 - (10) nënshkrimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, si dhe të personave të tjerë pjesëmarrës në mbledhje.
- Procesverbali i mbledhjes i dërgohet në formë shkresore dhe/apo me e-mail çdo anëtarit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të mbledhjes.

Vendimet e marra pa zhvilluar procedurat e mbledhjeve

- 14.10 Në raste të veçanta dhe për arsye objektive, anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, mund të marrin vendime edhe pa zhvilluar procedurat e mbledhjeve të zakonshme apo jashtëzakonshme, duke nënshkruar gjithsecili draftin e vendimit të përgatitur nga:
- (1) Administratorët e Shoqërisë;
 - (2) secili nga Ortakët e Shoqërisë; apo
 - (3) Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 14.11 Procedura e marrjes së vendimeve nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve pa zhvilluar paraprakisht procedurat e mbledhjeve të zakonshme apo jashtëzakonshme, mund të zbatohet vetëm në rast se vendimi për të cilin po kërkohet vota e anëtarëve të Asamblesë plotëson në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:
- (1) të gjithë anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve janë dakord paraprakisht për zhvillimin e kësaj procedure në rastin konkret;
 - (2) procedura ka të bëjë me marrjen e një vendimi në lidhje me ndonjë prej çështjeve të përcaktuara në pikat (10), (11), (12) dhe (13), të pikës 12.1, të nenit 12 të këtij Statuti.



14.12 Nga momenti i inicimit të procedurës së nënshkrimit nga Ortakët të draft vendimit të propozuar, e deri në momentin e hyrjes së tij në fuqi, secili prej Ortakëve (apo përfaqësuesit e tyre me prokurë) ka të drejtë që të anulojë procedurën e iniciuar të marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve pa u zhvilluar paraprakisht procedurat e mbledhjeve të zakonshme apo jashtëzakonshme, mjafton që gjatë kësaj periudhe ai të:

- (1) të bëjë shënimin përkatës në draftin e paraqitur për nënshkrim; apo
- (2) të njoftojë, në çfarëdolloj forme, në lidhje me këtë vendim/qëndrim të tijin anulues, propozuesit e draftit, dhe anëtarët e tjerë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Mosmarrja/mosdhënia e nënshkrimit nga ana e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve (apo e përfaqësuesve të tyre me prokurë), në lidhje me draft vendimin e propozuar, do të konsiderohet gjithmonë si refuzim nga ana e tyre i draft vendimit të propozuar.

Neni 15 Administratorët

15.1 Administratorët e Shoqërisë emërohen me unanimitet votash të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, për një mandat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë të pakufizuar rizgjedhjeje. Administratorët e Shoqërisë mund të shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në çdo kohë, me apo pa arsye, me shumicë të zakonshme të votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, dhe në rastin kur Shoqëria ka vetëm dy Ortakë me votën e njërit prej tyre.

15.2 Administratorë të Shoqërisë do të jenë personat si më poshtë:

- (1) z. Emiliano DOKO, shtetas Shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i lindur më datë 07.06.1979 në Kuçovë, Shqipëri; banues në adresën: "Rr. Petro Nini Luarasi", Pallati "Daniela", Tiranë, Shqipëri"; mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. 034332016.

15.3 Secili prej Administratorëve të Shoqërisë ka të drejtën dhe detyrimin që të përfaqësojë dhe menaxhojë Shoqërinë, me fuqi të plotë dhe në mënyrë të pavarur, brenda kompetencave të deleguara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, ky Statut, dhe kuadri përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16 Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorëve

16.1 Administratorët e Shoqërisë, sipas ndarjes së kompetencave të bëra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, dhe në përputhje dhe në zbatim të: (i) vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, (ii) përcaktimeve të bëra në këtë Statut, si dhe (iii) legjislacionin përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë; kanë për kompetencë dhe përgjegjësi:



Kompetenca dhe përgjegjësi që lidhen me organizimin

- (1) të përfaqësojnë Shoqërinë dhe nënshkruajnë dokumente në emër të saj, ndaj çdo entiteti shtetëror apo privat, fizik dhe/apo juridik, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- (2) të menaxhojnë dhe mbikëqyrin aktivitetet dhe asetet e Shoqërisë nën kompetencën e tyre, si dhe të vënë në zbatim politikat e biznesit të Shoqërisë të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- (3) të kujdesen që Shoqëria dhe nëpunësit e saj të zbatojnë me korrektësi kuadrin përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- (4) të informojnë rregullisht të gjithë Ortakët e Shoqërisë në lidhje me ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë dhe në bazë të kërkesës së tyre tu vendosin në dispozicion çdo informacion dhe dokumentacion, shkresor apo elektronik, pa asnjë lloj kufizimi përveç atyre që lidhen me ruajtjen dhe mbrojtjen e një sekreti tregtar të Shoqërisë sipas përcaktimeve të bëra në nenin 18 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- (5) të hartojnë, aprovojnë dhe më pas të përcjellin për shqyrtim dhe miratim në Asamblesën e Përgjithshme të Ortakëve strukturën organizative të Shoqërisë dhe/apo çdo amendim të saj;
- (6) të paralajmërojë në kohën e duhur organet drejtuese të Shoqërisë në lidhje me çdo rrethanë/rrezik/risk që kërcënon seriozisht veprimtarinë e Shoqërisë;
- (7) të menaxhojnë dhe finalizojnë çdo aspekt procedural/material që ka të bëjë me lidhjen/zbatimin/prishjen e kontratave të punës me punonjësit e shoqërisë nën varësinë e tyre;
- (8) të menaxhojnë dhe finalizojnë çdo aspekt procedural/material që ka të bëjë me lidhjen/zbatimin/prishjen e kontratave të shërbimit me: (i) Partnerët, (ii) palët e treta, (iii) audituesit, likuiduesit, dhe/apo ekspertët kontabël (nëse ka); pasi të jetë siguruar në çdo rast dhe për çdo fazë dhe miratimi final i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- (9) të administrojnë protokollin e brendshëm të Shoqërisë, ku përfshihet informacioni protokollar në lidhje me çdo komunikim të brendshëm dhe të jashtëm të Shoqërisë, shkresor apo elektronik;
- (10) të krijojnë/azhurnojnë/administrojnë një regjistër të veçantë ku të evidentohet: nënshkrimi zyrtar (firma), shkrimi i emrit dhe mbiemrit, adresa zyrtare postare, adresa zyrtare e e-mail(it), numri zyrtar i telefonit mobile, dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm i: (i) anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre me prokurë; (ii) Administratorëve të Shoqërisë; (iii) çdo punonjësi tjetër të Shoqërisë me detyra të rëndësishme ekzekutive dhe/apo menaxheriale;
- (11) të krijojnë/azhurnojnë/administrojnë një regjistër të veçantë ku të evidentohen certifikatat e lëshuara në lidhje me kuotat dhe transferimet që mund ti kenë ndodhur atyre;
- (12) të ushtrojnë çdo kompetencë/përgjegjësi tjetër që i njihet nga kuadri përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe/ose ky Statut;



Kompetenca dhe përgjegjësi që lidhen me financat dhe asetet

- (13) të hartojnë, aprovojnë duke garantuar cilësinë dhe ligjshmërinë e tyre dhe më pas të përcjellin për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve, përpara datës 1 (një) dhjetor të çdo viti: (i) planin e biznesit dhe (ii) buxhetin e Shoqërisë për vitin e ardhshëm financiar;
- (14) të hartojnë, aprovojnë duke garantuar cilësinë dhe ligjshmërinë e tyre dhe më pas të përcjellin për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve, përpara datës 31 (tridhjetë e një) mars të çdo viti: (i) raportin në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë nën kompetencën e tyre për vitin e mëparshëm financiar; (ii) pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mëparshëm financiar; (iii) përfitimet dhe humbjet e Shoqërisë për vitin e mëparshëm financiar; (iv) raportin e audituesve (nëse ka) për vitin e mëparshëm financiar; (v) inventarin e aseteve dhe detyrimeve të Shoqërisë për vitin e mëparshëm financiar;
- (15) të marrin masa për të siguruar që auditimi i librave dhe i të dhënave financiare të shoqërisë të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- (16) të nënshkruajnë urdhër pagesat apo çeket apo autorizojnë ngarkimin e shpenzimeve apo pagesat në llogarinë bankare të Shoqërisë dhe/ose vendosjen e garancive;
- (17) të kërkojnë dhe të arkëtojnë të ardhurat e Shoqërisë dhe të kryejnë depozitime në llogaritë bankare të Shoqërisë;
- (18) të hapin llogari bankare dhe/ose të transferojnë fondet ndërmjet llogarive bankare të Shoqërisë dhe/ose llogarive bankare të Shoqërisë dhe çdo pale të tretë; pasi të jetë siguruar në çdo rast dhe për çdo fazë dhe miratimi final i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- (19) të caktojnë/emërojnë (me prokurë) dhe/apo pezullojnë/shkarkojnë/tërheqin (me vendim) personat e autorizuar për të kryer veprime në lidhje me llogaritë bankare dhe kreditë e Shoqërisë; pasi të jetë siguruar në çdo rast dhe për çdo fazë dhe miratimi final i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- (20) të menaxhojnë dhe finalizojnë çdo aspekt procedural/material që ka të bëjë me lidhjen/zbatimin/prishjen në emër të Shoqërisë:
 - (i) të kontratave të kredisë/huas apo çdo marrëveshje tjetër, me vlerë financiare mbi 100.000 (njëqind mijë) LEK (ALL);
 - (ii) të kontratave/marrëveshjeve në të cilat Shoqëria merr përsipër detyrime financiare në vlerë mbi 1.000.000 (një milion) LEK (ALL) (të ndryshme nga kontratat e punësimit dhe ato të lidhura me Partnerët);
 - (iii) të kontratave/marrëveshjeve për garantimin e detyrimeve të palëve të treta;
 - (iv) të kontratave/marrëveshjeve për blerjen dhe apo marrjen/dhënien me qira të pasurive të paluajtshme;
 - (v) të kontratave/marrëveshjeve të donacionit/dhurimit;pasi të jetë siguruar në çdo rast dhe për çdo fazë dhe miratimi final i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



- 16.2 Në rastet kur Administratorët nuk respektojnë kufijtë e mandatit të tyre, çdo vendimmarrje e tyre dhe çdo veprim i kryer në mosrespektim/shkelje të përcaktimeve të bëra në pikën 14.5, të nenit 14, të këtij Statuti, do të konsiderohet si “nul” dhe i pavlefshëm, dhe Administratorët do të jenë përgjegjës për çdo pasojë që do të rezultojë nga vendime/veprime të tilla, përfshirë këtu por jo e kufizuar në, përgjegjësinë për dëmet e shkarkuara Shoqërisë, Ortakëve të saj dhe palëve të treta.
- 16.3 Administratori do të shkarkohet nga detyra dhe do të jetë përgjegjës për dëmet, nëse ai vepron në kontradiktë me këtë Statut, apo pa miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve ka pranuar mandatin si Administrator apo zotëron kuota apo përqindje në një shoqëri tjetër në konkurrense (me të njëjtin objekt dhe aktivitet) apo në konflikt interesi me Shoqërinë, apo nëse është përfshirë në transaksione të ngjashme civile apo konkurrence duke vepruar në emrin e tij ose në emrin e një personi tjetër fizik apo juridik.
- 16.4 Autorizimi i Administratorit për të përfaqësuar Shoqërinë mund ti delegohet palëve të treta vetëm për veprime specifike, të mirëpërcaktuara siç përcaktohet në prokurën speciale apo në rregulloren e brendshme, dhe vetëm brenda kufijve të këtij Statuti dhe me miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 17 **Ndalimi i konkurrencës**

- 17.1 Ortakët e Shoqërisë, përfaqësuesit e tyre me prokurë, dhe/apo Administratorët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me Shoqërinë.
- 17.2 Ndalimi i mësipërm, i përcaktuar në pikën 17.1, të nenit 17, të këtij Statuti, të këtij neni, mund të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 17.3 Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 17.1, të nenit 17, të këtij Statuti shkel ndalimin e konkurrencës, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të zbatojë përcaktimet ligjore të bëra në nenin 17, pikat 4, 5 dhe 6, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.



KAPITULLI – IV TË TJERA

Neni 18 Viti financiar

- 18.1 Viti ushtrimor financiar fillon më datë 1 (një) Janar të çdo viti kalendarik dhe mbaron më datë 31 (tridhjetë e një) Dhjetor të po atij viti. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit mbaron më datë 31 (tridhjetë e një) Dhjetor të po atij viti.

Neni 19 Pasqyrat vjetore financiare

- 19.1 Pasqyra vjetore financiare të Shoqërisë duhet të përgatitet jo më vonë se 3 (tre) muaj pas përfundimit të vitit financiar.
- 19.2 Administratori/Administratorët kanë detyrimin që ti paraqesin Ortakëve pasqyrat vjetore financiare pa asnjë vonesë dhe menjëherë pas hartimit të tyre duke garantuar cilësinë dhe ligjshmërinë e tyre.
- 19.3 Pasqyrat vjetore financiare pasi miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve i përcillen në kohë autoriteteve përkatëse shtetërore financiare nga Administratorët e Shoqërisë, në përputhje me përcaktimet e bëra në kuadrin përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20 Shpërndarja e fitimeve

- 20.1 Vendimet mbi shpërndarjen dhe përdorimin e fitimeve të Shoqërisë merren nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 20.2 Shoqëria do të shpërndajë Ortakëve të saj të gjithë fitimet që mund të arrihen pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat dhe detyrimet në respektim të kuadrit përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 20.3 Ndarja e fitimeve bëhet në të njëjtën kohë për të gjithë Ortakët e Shoqërisë, duke respektuar përqindjet si më poshtë:
- (1) z. Ermal YZEIRAJ - 50 (pesëdhjetë) % (përqind);
 - (2) z. Emiliano DOKO - 50 (pesëdhjetë) % (përqind).

Neni 21 Shpërbërja dhe likuidimi

- 21.1 Shoqëria mund të jetë subjekt i shpërbërjes vetëm në rastet kur:
- (1) një gjë e tillë vjen si domosdoshmëri në zbatim të përcaktimeve të bëra në kuadrin përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë; apo
 - (2) një gjë e tillë vjen si pasojë e vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



- 21.2 Shpërbërja dhe likuidimi i Shoqërisë, do të bëhet në përputhje me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe kuadrin tjetër përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KAPITULLI – V DISPOZITA TË FUNDIT


Neni 22 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 18.1 Mosmarrëveshjet ndërmjet Shoqërisë dhe punonjësve të saj do të zgjidhen në përputhje me kuadrin përkatës rregullator të fushës së punësimit në Republikën e Shqipërisë.
- 18.2 Mosmarrëveshjet ndërmjet Ortakëve, si dhe ndërmjet Shoqërisë dhe palëve të treta, kur zgjidhja e tyre me mirëkuptim nuk është e mundur, do të zgjidhen nga Gjykatat kompetente sipas juridiksionit dhe procedurave të përcaktuara nga kuadri përkatës rregullator në fuqi në Republikën e Shqipërisë apo në kontratat specifike të lidhura me to. Për një zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjeve, palët mund të vendosin edhe në çuarjen e çështjes para një Arbitrazhi ad-hoc apo të organizuar në Republikën e Shqipërisë.

* * *


Ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë, u hartua në 4 (katër) kopje identike në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë juridike, secila prej të cilave u nënshkrua sot më datë 21.10.2020 nga Ortakët themelues të Shoqërisë:

ORTAKËT:



[Emër / Mbiemër / Firmë]

z. Ermal YZEIRAJ



[Emër / Mbiemër / Firmë]

z. Emiliano DOKO

**NOTER
ERMAL XH. HAMZAJ**

